



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L – 071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 29/27, dhjetor 2011), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** Vendimi për ndryshimin e emrit të rrugës së "Shtëpisë – Shkollë", nga ajo aktuale rr."Hasan Ramadani" në rr. "Shkollat e Herticëve", në mënyrë që ajo më mirë të reflektojë rëndësinë dhe rolin e muzeut dhe sistemit paralel të arsimit në Kosovë.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-016/01-0263798/18, më 01.11.2018

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta

